



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. Prot.

Vlorë, më 27.04.2018

Vendim
Nr. 8, datë 27.04.2018

PËR FINANCIMIN E BOTIMIT TË LIBRIT "GJUHËSI E KRAHASUAR"

Bazuar në nenin 3, pika 3, shkronjat **c, d**, neni 47, 49, pika 1 shkronja **a** të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 27.04.2018,

VËREN SE:

Përpara Bordit të Administrimit është përcjellë për shqyrtim nga ana e Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë kërkesa protokolluar në U.V me nr. 451 Prot, datë 06.04.2018 e Prof. Dr. Nexhip Mërkuri me objekt financimin e botimit të librit "*Gjuhësi e krahasuar*" në vlerën 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Në kërkesë argumentohet se. "*Ky botim do të jetë me shumë dobi për studentët universitarë të tre niveleve të studimit në Shqipëri, Maqedoni, Kosovë e Mal të zi, për studiuesit e rinj në shkallë të ndryshme të kualifikimit shkencor...*"

Pasi shqyrtoi kërkesën e sipërcituar, Bordi i Administrimit vëren se ajo nuk plotëson kushtet formale të një shkrese. Më konkretisht, shkresa është pa datë edhe pse është protokolluar në U.V në datë 06.04.2018.

Së dyti, shkresa i drejtohet Senatit Akademik dhe jo Bordit të Administrimit.

Përsa i përket thelbit të saj, Bordi i Administrimit unanimisht mendon se kërkesa është e pabazuar në ligj dhe për këtë arsye duhet të rrezohet.

Në kërkesë nuk argumentohet se cilat janë dobitë që përfiton universiteti nga botimi i këtij libri. Siç përmendet dhe në argumentat e kërkuesit, ky libër i drejtohet një kategorie të gjerë subjektësh, lexuesish dhe kërkuesish shkencorë, tek të cilët do të shitet ky libër. Nga shitja e tij, autori do të përfitojë të ardhura, të cilat do të mbulojnë shpenzimet e tij për botimin e këtij libri. Për më tepër, kërkesa e paraqitur nuk është e shoqëruar me një relacion ku të përmbledhet procedura që ka ndjekur autori për të siguruar ISBN e librit në mënyrë që propozimi/kërkesa të konsiderohej formale.

Në përfundim, Bordi i Administrimit mendon se financimi i këtij libri nuk është në kompetencat e tij dhe në misionin që i ka ngarkuar ligji nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*".

Për këtë arsye, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 27.04.2018 me votim unanimit,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit Prof. Dr. Nexhip Mërkuri për financimin e botimit të librit “Gjuhësi e krahasuar”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet Prof. Dr. Nexhip Mërkuri.

Dr. Rezana Vrapit – Kryetar

Florian Nurçe – anëtar

Eduard Ahmeti- anëtar

Dr. Enida Pulaj – anëtar

Dr. Elsajed Rexhaj – anëtar

Dr. Marinela Muço – anëtar

Ornela Koleka - anëtar